Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 30.12.2011
| Nr.I organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| --- | --- | --- | --- |
| 01-013/2346 | | | |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 17.1 pika r) dhe 40 paragrafi 2 pika l.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 36 paragrafi 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2011 aprovon këtë:

# V E N D I M
## ZYRTARIZIMIN E ANSAMBIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE "KEMAJL AZIZI" SI ANSAMBËL ZYRTAR I KOMUNËS SË VITISË

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, zyrtarizon Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "Kemajl Azizi" si ansambël zyrtar i cili e përfaqëson Komunën e Vitisë në manifestime kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në të gjitha festat zyrtare dhe publike të organizuara nga Komuna e Vitisë.

Neni 2

AKV " Kemajl Azizi" organet udhëheqëse, mbikëqyrëse dhe funksionin e ushtron në bazë të Ligjit 03/L-056 për Ansamblin Kombëtar Shtetëror të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për ansamblet tjera.

Neni 3

AKV „Kemajl Azizi" do të mbështetet financiarisht me 25% (njëzetë e pesë përqind) të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë të parapara për një vitë buxhetor.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

O1.Nr.________
Viti, 28.12.2011

KRYESUESI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi